



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/482  
Datë: 6/9/2021

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datën 06.09.2021, mori

**V E N D I M**

*Për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve në nivelin baçelor, master dhe doktoratë, sipas kushteve në vijim:*

- I. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2013/14, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e dy (2) viteve paraprake të studimeve, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më datë 30.9.2022.
- II. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2013/14, dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet që studimet përfundojnë me mbrojtje të temës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më datë 30.9.2022, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa temë të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më datë 30.09.2022.
- III. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2011/12, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e tri (3) viteve paraprake të studimeve, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më datë 30.9.2022.
- IV. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2011/12 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet që studimet përfundojnë me mbrojtje të temës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më datë 30.9.2022, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa temë të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më datë 30.09.2022
- V. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2009/10, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit të studimeve si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e katër (4) viteve paraprake të studimeve, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më dt. 30.9.2022.

- VI. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2009/10 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet që studimet përfundojnë me mbrojtje të temës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më datë 30.9.2022, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa temë të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më datë 30.09.2022.
- VII. Studentët e nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2017/18, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe kanë dhënë 50% të provimeve të parapara, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit akademik 2020/21 pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më dt. 30.9.2022
- VIII. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2017/18 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më datë 30.9.2022.
- IX. Studentët e nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2015/16, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe nëse kanë përfunduar provimet e vitit të parë, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit akademik 2020/21 pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më dt. 30.9.2022.
- X. Studentëve të nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2015/16 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më datë 30.9.2022.
- XI. Studentëve të nivelit baçelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e parapara në programet që studimet përfundojnë me mbrojtje të temës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, **për herë të fundit u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri në përfundim të afatit të qershorit 2022.** Provimet për këtë kategori të studentëve do të organizohen nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse, respektivisht nga komisionet e fushave përkatëse në përbërje prej tre (3) anëtarëve. Kërkesat për vazhdim të diplomimit pas afatit të përcaktuar si në këtë paragraf, nuk do të merren në shqyrtim.
- XII. Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve baçelor dhe master të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta për vit studimi, ndërsa aktualisht janë në vitin e parë (I), dytë (II), tretë (III) katërt (IV) apo pestë (V), por që nuk kanë përfunduar provimet sipas kushteve të përcaktuara në pikat I deri X të këtij vendimi, u mundësohet vazhdimi i studimeve sipas plan-programit të ri të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.
- XIII. Studentët e nivelit të doktoratës të cilët kanë tejkaluar afatin e kohëzgjatjes së studimeve të përcaktuar sipas rregullores në fuqi në kohën e regjistrimit të studimeve, u vazhdohet periudha e mbrojtjes së doktoratës deri më dt. 30.9.2022.

- XIV. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të nenit 152 të Statutit nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
- XV. Njësitë akademike obligohen që këtë vendim ta publikojnë në tabelat e shpalljeve në njësitë përkatëse akademike.
- XVI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimi nr. 2/30, dt. 30.09.2020.
- XVII. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë menaxhmenti dhe zyrtarët për çështje të studentëve të njësive përkatëse akademike të UP-së.
- XVIII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat dhe vlen për vitin akademik 2021/22.

### Arsyetim

Senati pasi shqyrtoi me kujdes kërkesën e Parlamentit të studentëve për lejimin e vazhdimit të kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët në nivelin baçelor, master dhe doktoratë, të cilët kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të viteve pa i përfunduar me sukses studimet, duke pasur parasysh edhe rrethanat e jashtëzakonshme nën kushtet e Pandemisë, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike përkatëse;
3. Menaxhmentit të UP-së;
4. Sekretarëve të Fakulteteve;
5. Sekretarit të përgjithshëm;
6. Zyrës për Çështje Akademike;
7. Zyrës për çështje të studentëve.



Kryesuesi i Senatit të UP-së

*Naser Sahiti*  
Prof. dr. Naser Sahiti, Rektor